

Kryetare Natasha Mulaj

Znj. Mulaj është lindur në Tropojë, në vitin 1972. Në vitin 1990, ka fituar konkursin dhe është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë.

Ka punuar pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me detyrë ndihmësgjyqtare dhe gjyqtare.

Më pas, në Gjykatën e Lartë, me detyrë ndihmëse ligjore (këshilltare ligjore), pranë Kolegjit Civil dhe Kolegjit Penal.

Në kuadër të veprimtarisë së saj profesionale, znj. Mulaj ka kryer trajnime të ndryshme pranë Shkollës së Magjistraturës në vitet 2005, 2009, 2010, si: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut: e drejta e jetës, ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e drejta e lirisë dhe e sigurisë, sipas neneve 2, 3, 5 të KEDNJ (Council of Europe, European Commission); Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut: mbrojtja e pronësisë si e garantuar nga neni 1 i Protokollit të KEDNJ-së (Council of Europe, European Commission); I mituri dhe e drejta familjare (UNICEF); Veprimet juridike: pavlefshmëria e veprimeve juridike; E drejta administrative; Veprat penale kundra personit; I mituri, e drejta civile dhe procesi civil; Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në procesin penal; Çështja e etikës profesionale; Pronësia intelektuale; Masat e sigurimit personal, revokimi, zëvendësimi dhe shuarja e masave të sigurimit, kompensim për burgim të padrejtë; Gjykimet e posaçme; Veprat penale kundër shtetit të kryera nga nëpunës shtetërorë; Ekzekutimi i detyrueshëm: mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të vendimit; Krimet ndaj mjedisit; Use of Labour International standards and the Labour Law in Albanian (ILO, International Training Centre); Titujt ekzekutivë në procedurën civile dhe titujt ekzekutivë në kuptimin e ligjit të posaçëm; Praktika e GJEDNJ-së lidhur me mosekzekutimin e detyrimeve të shtetit ndaj individëve. Detyrimet që burojnë prej vendimeve gjyqësore; Kërkimi ligjor në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (USAID); Shkrimi dhe arsyetimi i vendimit gjyqësor (USAID); Pronësia intelektuale (Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit).

Aktualisht, znj. Mulaj është gjyqtare pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese dhe njëkohësisht drejtuese e tij që prej datës 25 korrik 2017.